

KONTRATË SHITJE KUOTASH TË SHOQËRISË “@ STAZH LOUNGE” SHPK

Sot më datë 01.11.2021 në Tiranë, nënshkruhet kjo kontratë shitje kuotash mes palëve kontraktuese si vijon :

Pala SHITËSE

Z.Erjon MARKU, lindur në Krujë, i datëlindjes 20.08.1988 , shtetas Shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i dokumentit të identifikimit me nr personal 180820013K, që më poshtë në këtë kontratë do të referohet si palë shitëse

Pala BLERËSE

Z.Daniel NACO, lindur në Pogradec, i datëlindjes 27.10.1988 , shtetas Shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i dokumentit të identifikimit me nr personal 181027048P, që më poshtë në këtë kontratë do të referohet si palë blerëse

shprehën vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë për të përpiluar dhe nënshkruar kontratën e shitjes së kuotave të kapitalit themeltar, si më poshtë :

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Pala shitëse është ortak i vetëm i shoqërisë “@ Stazh Lounge” SHPK regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit datë 08.06.2021 me numer unik identifikimi M11808010R me ortak si më poshtë;

-Erjon Marku, zotërues i 100% të kuotave të kapitalit të përbërë nga 1 kuotë e vetme me një vlerë nominale prej 100.000 lekë.

OBJEKTI I KONTRATËS

Pala shitëse, z. Erjon Marku , i shet me vullnet të lirë e të plotë palës blerëse 50% të kuotave të kapitalit të shoqërisë me vlerën 50.000 lekë, që zotëron në shoqërinë “@Stazh Lounge” SHPK

Pala blerëse , Z.Daniel Naco, me vullnet të lirë e të plot, i pranon palës shitëse z.Erjon Marku 50% të kuotave të kapitalit të shoqërisë në vlerën nominale 50.000 lekë gjithsej.



TRANSFERIMI I PRONËSISË

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, pala shitëse zhvishet nga 50% e kuotave të kapitalit të shoqërisë dhe pala blerëse bëhet zotëruese e 50% të kuotave të kapitalit të shoqërisë.

Pas nënshkimit të kontratës pala blerëse merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lindin nga ortakëria që nga momenti i nënshkimit të kontratës.

Pala blerëse nuk ka asnjë përgjegjësi për detyrimet që pala shitëse mund të ketë jashtë shoqërisë.

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Kontrata u përpiluar në 3 kopje me fuqi të barabartë, njëra prej të cilave depozitohet në regjistrin tregtar duke u bërë shënimet për ndryshimet përkatëse.

PALËT KONTRAKTUESE

PALA SHITËSE

Z.Erjon MARKU

Erjon Marku




PALA BLERESE

Z.Daniel NACO

DANIEL NACO

